



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

PAKR.nr.104/2022

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për Krime të Rënda, kolegji i përbërë nga gjyqtarët Abdullah Ahmeti, kryetar, Vaton Durguti dhe Kreshnik Radoniqi, anëtarë, me bashkëpunëtoren profesionale Alba Makolli, në lëndën penale kundër të akuzuarit E.S. për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, duke vendosur sipas ankesës e mbrojtësit të akuzuarit E.S.-av.Irfan Zushi, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë – Departamenti për Krime të Rënda PKR.nr.232/2021 të dt.28.01.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur konform nenit 390 të KPPK, me datë 24.03.2022 morri këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e mbrojtësit të akuzuarit E.S.-av.Irfan Zushi, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë – Departamenti për Krime të Rënda PKR.nr.232/2021 të dt.28.01.2022, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Mitrovicë - Departamenti për Krime të Rënda, me aktgjykimin PKR.nr.232/2021 të dt.28.01.2022 e ka shpallur fajtor të akuzuarin E.S. për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së dhe e ka gjykuar me dënim me gjobë në shumë prej 400 (katërqind) euro, të cilën shumë obligohet ta paguajë brenda afatit prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Nëse, i akuzuari nuk e paguan gjobën në afatin e caktuar, atëherë dënimi me gjobë mund t'i zëvendësohet me dënim me burgim, ku një ditë burgim do t'i llogaritet me 20 (njëzet) euro të gjobës.

Është obliguar i akuzuari që t'i paguajë shpenzimet e procedurës penale shumë prej 20 euro, në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 20 euro, dhe në emër të kompensimit të viktimave të krimit shumë prej 50 (pesëdhjetë) euro, të gjitha këto në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën pasojat e përmbarimit të dhunshëm.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë ka ushtruar mbrojtësi i të akuzuarit E.S.-av.Irfan Zushi, për shkak të lartësisë së dënimit, me propozim që të aprovohet ankesa, ndërsa aktgjykimi të ndryshohet dhe të akuzuarit ti shqiptohet dënimi më i ulët me gjobë në bazë të rrethanave objektive dhe materiale të akuzuarit.

Prokurori i Apelit në parashtresën PPA/I.nr.114/22 të dt. 24.02.2022 ka propozuar që të refuzohet si e pabazuar ankesa e mbrojtësi i të akuzuarit E.S.-av.Irfan Zushi, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Konform nenit 390 par.1 të KPPK-së, Gjykata e Apelit mbajti seancën e kolegjit pa prezencën e palëve, meqenëse kemi të bëjmë me dënim me gjobë.

Gjykata e Apelit, e shqyrtoi aktgjykimin e ankimuar, detyrimisht në kuptim të dispozitës së nenit 394 par.1 të KPPK, vlerësoi pretendimet ankimore të akuzuarit, së bashku me shkresat tjera të lëndës dhe pas vlerësimit të shkresave të lëndës, gjeti se **ankesa është e pabazuar**.

Pretendimet ankimore

Në ankesën mbrojtësi i të akuzuarit E.S.-av.Irfan Zushi, pretendon se dënimi i shqiptuar nga gjykata e shkallës së parë është i papërballueshëm në kushtet dhe në momentin e vendosjes, duke përshkruar më tej çështjen e vjedhjes së banesës së të akuzuarit dhe mohimin e gjetjes së armës nga policia deri në ngritjen e aktakuzës me pretendim se gjatë shqyrtimit gjyqësor as Prokuroria e as Policia e Kosovës nuk kanë arritur të sigurojnë të vetmet prova material për të vërtetuar dyshimin e bazuar se i pandehur është fajtor dhe përgjegjës penale për kryerjen e kësaj veprë për të cilën është akuzuar. Më tej shton se i mbrojturi i tij ka pranuar këtë vepër penale dhe mohon të ketë kryer veprën penale për qëllime të tjera, duke cekur se arma e avarisur në këmbëzën dhe mekanizmin qitës posedues i dokumentacionin të skaduar, anëtarë i shoqatës së gjuetarëve tërë këto japin një pasqyrë reale për marrjen të një aktgjykimi më lehtë, duke shtuar më tej se i mbrojturi i tij nuk ka të kaluar kriminale përpos kundërvajtjet për trafik, pastaj se është i pa punë, intelektual, kryefamiljar, prind dhe gjysh, me detyrim si qytetar ndaj obligimeve shtetërore po ashtu edhe ndaj familjes, shuma e dënuar sipas aktgjykimit do të rëndojë edhe më tepër gjendjen ekonomike familjare. Në këto rrethana, është propozuar si më lartë.

Gjetjet e Gjykatës së Apelit

Edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë nuk ankimohet për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, kjo Gjykatë vlerësoi sipas detyrës zyrtare dhe konstatoi se aktgjykimi i ankimuar nuk është i përfshirë me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, të cilët kishin me kushtëzua prishjen e aktgjykimit dhe se nuk është shkelur ligji penal në dëm të akuzuarit.

Po ashtu as gjendja faktike nuk ka qenë objekt i vlerësimit të kësaj gjykate, se me ankesë nuk mund të kontestohet në kuptim të nenit 383 par.2 të KPPK-së, meqenëse i akuzuari në shqyrtim fillestar të datës 24.01.2022, e ka pranuar fajësinë dhe Kryetari i trupit gjykues e ka aprovuar

pranimin e fajësisë nga i akuzuari, prandaj aktgjykimin e ankimuar kjo Gjykatë e vlerësoi vetëm në drejtim të pretendimeve ankimore përkitazi me vendimin mbi dënimin.

Lidhur me pretendimet ankimore të akuzuarit përkitazi me vendimin mbi dënim, kjo Gjykatë gjen se pretendimet në këtë drejtim janë të pabazuara. Kështu, gjykata e shkallës së parë me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese, ku si rrethanë lehtësuese ka vlerësuar pranimin e fajësisë, shprehjen e keqardhjes, premtimin se në të ardhmen nuk do të bie ndesh me ligjin, bashkëpunimin e të akuzuarit në të gjitha fazat e procedurës penale.

Gjykata e Apelit gjen si të pabazuar pretendimin ankimor të akuzuarit, përkitazi me pretendimet për armën e pagjetur dhe funksionalitetin e saj, për faktin se në rastin konkret i akuzuari e ka pranuar fajësinë në seancën e shqyrtimit fillestar ku të akuzuarit pasi i ishte lexuar aktakuza dhe njoftuar me të drejtat e tij e pas konsultimit me mbrojtësin e tij av. Irfan Zushi, e kishte pranuar fajësinë, i cili pranim i fajësisë është bërë konform nenit 248 të KPP-së dhe të cilin pranim të fajësisë gjykata e shkallës së parë e kishte pranuar, pasi Kryetari i Trupit Gjykues ishte bindur se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë.

Kjo Gjykatë i gjen si të pabazuara pretendimet ankimore të akuzuarit se nuk janë vlerësuar rrethanat lehtësuese sa duhet, sepse nga shikimi i arsyeve të dhëna nga ana e gjykatës së shkallës së parë në raport me vlerësimin e rrethanave, të njëjtat janë vlerësuar dhe marrë parasysh me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit dhe nuk ekziston ndonjë rrethanë e re që do të arsyetonte dënim më të butë si dhe duke marrë parasysh edhe gjendjen e mesme ekonomike të vet deklaruar, si në aktgjykimin e ankimuar. Prandaj, dënimi i shqiptuar është në funksion të parandalimit të kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe ndikoj në rehabilitimin e tij dhe të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, dhe me këtë dënim të shqiptuar të akuzuarit do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë në nenit 38 të KPRK-së.

Nga sa u tha më lartë, e në pajtim me dispozitën e nenit 401 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA
PAKR.nr.104/2022 më datë 24.03.2022

B.profesionale

Anëtarët e kolegjit

Kryetari i kolegjit

Alba Makolli

Vaton Durguti

Abdullah Ahmeti

Kreshnik Radoniqi